Br. No. 01-060/01-0043707/26
Data Data 22.10.2026

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality Skenderaj

Kuvendi i Komunës/SkupštinaOpštine/MunicipalityofAssembly

Në bazë të nenit 49, të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr. 03/L-040, të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 43 të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.01-110-385, të datës 03.12.2008, si dhe Rregulloren e Punës së Kuvendit nenit 27, e në pajtim me rregullat e procedurës.

Ekstrakt nga procesverbali i MBLEDHJES SË KUVENDIT KOMUNAL SKENDERAJ, i datës; **29.09.2026,** ora **10;00**

REND

1. Fjala hyrëse;
2. Miratimi i rendit të ditës;
3. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluara;
4. Propozim – Vendim për miratimin e buxhetit të Komunës së Skenderajt për vitin 2027 dhe parashikimi i buxhetit për vitin 2028-2029, **(raporton z. Behxhet Maliqi, Drejtor i DBF),**
5. Propozim – Vendim mbi lejimin e shfrytëzimit të mjeteve financiare në shumë prej 10,000€ (dhjetë mijë euro), për mbështetje financiare për Osman Bytyqi nga Fshati Abri e Poshtme, për rindërtim të shtëpisë së djegur si pasojë e zjarrit, **(raporton Kryetari i Komunës, z. Sami Lushtaku),**
6. Propozim për miratimin e vendimit për mbështetjen financiare për NPL Eko- Natyra SH.A. Skenderaj me shumën prej 50,000.00€ **(raporton Kryetari i Komunës z. Sami Lushtaku),**
7. Propozim për miratimin paraprak të vendimit për dhënien ne shfrytëzim të pronave të paluajtshme të Komunës së Skenderaj, në shfrytëzim afatgjatë deri në 99 vite personit fizik/ juridik, parcelat me numër 699-10, 565-2, 569-0, dhe 570-1 prona publike në pronësi të Komunës, zona Kadastrale Skenderaj**(raporton z. Granit Musliu, drejtor DGJKP),**
8. Propozim për miratimin e vendimit për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të Komunës, përmes procedurës së shprehjes se interesit; parcelat Kadastrale me numër 699-10, 565-2, 569-0, dhe 570-1 prona publike në pronësi të Komunës zona Kadastrale Skenderaj, **(raporton z. Granit Musliu, drejtor DGJKP),**

9. Propozim për miratimin e vendimit për formimin e Komisionit të ankesave për shqyrtimin e ankesave të palëve në procedurën e dhënies në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjate të pronës së paluajtshme të Komunës së Skenderajt, **(raporton z. Granit Musliu, drejtor DGJKP),**
10. Propozim – Vendim për miratimin e Draft – Planit Komunal për Ri-integrimin e qëndrueshëm të personave të Ri-atdhesuar dhe integrimi e të huajve në Komunën e Skenderajt 2026-2028,(**raporton Zyrtari për Komunitete dhe Kthim, z. Fatmir Balaj),**
11. Propozim – Vendim për shfuqizimin e vendimit Nr. 01-020/01-0020578/26, të datës: 04.06.2026, bazuar ne rekomandimin e Mapl-së, për zëvendësimin e anëtares se komitetit për komunitete **(raporton Kryesuesja e Kuvendit znj. Adelina Spahiu – Alija),**
12. Diskutim rreth raportit të përformancës së Komunave për vitin 2025, (raporton koordinatori i performancës komunale, z. Baki Beqiri),
13. Pyetjet e këshilltare nën piken të ndryshme.

Pikat shtesë

14. Deklaratë për krerët e UÇK-së, raporton Kryetari i Komunës, z. Sami Lushtaku,
15. Propozim – vendim për inicimin e procedurës për themelimin e QMF-së në Kuadër të QKMF-së, raporton z. Hasan Hoti DSHMS.

Kryesuesja e Kuvendit, Adelina Spahiu – Alija : Përshëndetje i nderuar Kryetar i Komunës se Skenderajt z. Sami Lushtaku, i nderuari Nënkryetar z. Fadil Nura, te nderuar përfaqësues te Mapl, anëtar te Kuvendit, drejtor te drejtorive, dhe ju te gjithë te pranishmit, te pranishëm ne sallë i kemi 22 anëtar, mungon me arsye Rushit Jeta, ndërsa bashkëngjiten gjatë seancës Valon Muslija, Vlora Jashari dhe Burim Veliu, ndërsa mungon pa arsye Hysni Mehani para se te fillojmë me rend dite i kemi dy pika shtesë Deklaratën për krerët e UÇK-së dhe propozim – vendimin për inicimin e procedurës për themelimin e QMF-së në kuadër të QKMF-së, kush është për qe deklarata për krerët e UÇK-së të hynë në rënd dite, konstatojmë se me 22 vota për, 0 kundër dhe 0 abstenim hynë në rënd dite deklarata për krerët e UÇK-së, vazhdojmë me piken e dytë shtese, Propozim – vendim për inicimin e procedurës për themelimin e QMF-së në Kuadër të QKMF-së, konstatojmë se me 17 për, 0 kundër dhe 2 abstenime hyn në këtë rënd dite ky propozim – vendim, para se te votojmë për këtë rënd dite kërkoj qe deklarata për krerët e UÇK-së të jetë pike e pare e rendit të ditës, votojmë për rënd dite, konstatojmë se me 17 për, 0 kundër dhe 2 abstenime miratohet rendit i ditës, vazhdojmë me piken e radhës shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar, e hap diskutimin pasi qe nuk ka për diskutim, votojmë tash, konstatojmë se me 20 vota për, 0 kundër dhe 0 abstenim miratohet procesverbali nga mbledhja e kaluar me përmasimin tek Abdullah Gashi tek subjekti politik te përmirësohet ,
Sekretaria e Kuvendit ; Përmirësohet procesverbali tek diskutimi i Abdullah Gashi, përmirësohet subjekti PDK, i cili ishte një lëshim teknik.
Kryesuesja e Kuvendit, Adelina Spahiu – Alija : vazhdojmë me piken e radhës Deklarata për krerët e UÇK-së,
Nënkryetari, z. Fadil Nura – Faleminderit Kryesuese, përshëndetje të gjithë të pranishmit, në emër të Kryetarit, po e lexoj deklaratën Kryetari i Komunës së Skenderajt, duke u bazuar në nenin 58 shkronja a) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, në mbledhjen e rregullt të datës 29.09.2026, nxjerrë këtë:

Deklaratë jo në Emrin timë

Kryetari i Komunës së Skenderajt, duke respektuar pavarësinë e gjyqësorit, shpreh mospajtimin e tij të thellë me aktgjykimin e shkallës së parë të Dhomave të Specializuara të Kosovës, të datës 16 shtator 2026, ndaj ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Presidentit Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit.

Kryetari i Komunës dhe Kuvendi Komunal rithekson se lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ishte vazhdimësi e luftës për liri dhe çlirim, e lindur nga rrethanat e rënda të represionit, dhunës, vrasjeve dhe dëbimit të popullsisë shqiptare të Kosovës.

Kuvendi Komunal i Skenderajt shpreh solidaritetin e plotë me familjet e Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, si dhe me të gjithë ata që këtë proces e kanë përjetuar me dhimbje dhe shqetësim.

Kuvendi u bën thirrje qytetarëve të Skenderajt dhe të gjithë Kosovës që, pavarësisht dhimbjes dhe emocioneve të forta, të ruajnë qetësinë, dinjitetin dhe unitetin, duke shprehur qëndrimet e tyre në mënyrë paqësore, demokratike dhe institucionale.

Duke pasur parasysh se vendimi është shpallur me formulimin "Në emër të popullit të Kosovës", Kuvendi Komunal i Skenderajt përcjell qartë mesazhin e qytetarëve të saj:

"JO NË EMRIN TIM!"

Ky qëndrim shpreh mospajtimin me dënimin e shqiptuar dhe të drejtën e qytetarëve për të kërkuar drejtësi dhe trajtim të drejtë për ish-krerët e UÇK-së:

Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi, ju faleminderit.
Kryesuesja e Kuvendit, Adelina Spahiu – Alija : Faleminderit Nënkryetar, pasi që kërkon votim për përkrahje deklarata, shkojmë me votim, konstatojmë unanimisht përkrahet deklarata për krerët e UÇK-së. Vazhdojmë me piken e radhës Propozim – Vendim për miratimin e buxhetit të Komunës së Skenderajt për vitin 2027 dhe parashikimi i buxhetit për vitin 2028-2029, **(raporton z. Behxhet Maliqi, Drejtor i DBF)**,
Behxhet Maliqi, DBF – Faleminderit Kryesuese, përshëndetje për të gjithë po e prezantojë në pika të shkurta propozim buxhetin për vitin 2027 dhe parashikime për vitet 2028 – 2029, pasi qe materialin e keni marr me kohë ky propozim vije pas përfundimit të dëgjimeve buxhetore qe i kemi mbajtur në bashkësi lokale dhe këtu ne Kuvend bashkë me anëtar të Kuvendit, ky buxhet është planifikim për vitin 2027 dhe parashikim për vitet 2027-2029.
Buxheti për vitin 2027 është 20,814,790.00€, parashikimi për vitin 2028 është 21,597,459.00€, dhe për vitin 2029 buxheti është 22,782,099.00€, te neni 2 janë të cekura burimet e financimit të buxhetit, po e prezantoj në pika të shkurtra pasi qe materialin e keni marr me kohë , pastaj tek neni 3 tabela prezanton nga granti i përgjithshëm , për arsim shëndetësi transferi i shërbimeve rezidenciale te hyrat vetanake qe për vitin 2027 gjithsej buxheti është 20,814,790.00€ si dhe per vitet 2028 dhe 2029 qe e shihni ne këtë tabele pastaj tek neni 4 i shihni shpenzimet e buxhetit për vitin 2027, duke filluar nga zyra e Kryetarit e me radhë deri tek arsim dhe shkencë, pastaj buxheti nëpër drejtori dhe programe ne fund prezanton listën e projekteve kapitale, nuk po e zgjati me shumë pasi të gjitha i keni në material, faleminderit.

Kryesuesja e Kuvendit, Adelina Spahiu – Alija : Faleminderit drejtor, e hapi diskutimin.
Afrim Kabashi – Faleminderit Kryesuese, përshëndetje për të gjithë. Tek lista e projekteve kapitale te parapara për realizim drejtor tek emërtimet e projekteve a keni marre ndonjë rekomandim apo vërejtje sugjerim nga ana e këshilltareve komunal te cilët kane paraqite gjate seancave te mbajtura, e ku mesa pashe ne raport jo.
Neve anëtarëve te kuvendeve komunale na ka ardhe përmes emailit nga ana e rrjetit te grave te Kosovës qe me rastin e miratimit te buxhetit komunal ti keni parasysh ne mbështetje.
Andaj pyetja ime është gjate përpilimit te buxhetit te projektet kapitale a i keni marre parasysh rekomandimet e dërguara ne prioritet ne projektet e dërguara nga ana e tyre.
Tek lista e projekteve i pashe te njëjtat emërtime e projekteve e te cilat do ta kenë besoje fatin e realizimit sikurse viteve kaluara, ku thuajse shumica e projekteve kane mbetur ne gjysme te punës te parealizuara.
Tek renovimi i objekteve te QKMF-së,QMF-së,AMF-së a keni paraparë apo keni bere ndonjë planifikim për rehabilitim e ambulantes ne Polac e ku besoje e dini mire gjendjen e sajc momentale.
Drejtor tek emërtimet Mallra dhe shërbimet tek disa kode kishe nje rritje e paraparë qe kishi parapa andaj desha te di për çka është fjala tek kodi 13460 shërbime kontraktuese tjera vlera 641.748.00 euro
Tek kodi 13501 Mobilet vlera e paraparë 62.515.00 euro.
Tek kodi 13610 furnizimet për zyre vlera e paraparë 140.150.00 euro
Unë edhe përkundër vërejtjeve ne përpilimin e buxhetit, qytetareve te komunës Skenderajt ju uroje buxhetin e planifikuar për vitin 2027.
Behxhet Maliqi, DBF – Faleminderit Afrim, fillimisht është mirë me marrë pjesë në dëgjimc buxhetore që kanë qenë të hapura për të gjithë, besoj që 90% të kërkesave janë përfshi në buxhet, a ka nevojë që ky buxhet me pas projekte ende ka nevojë mirëpo këto janë mundësit financiare, çdo rritje e pagave ndikon në kufizimin e buxhetit, pyetje për shërbimet kontraktuale përfshin shërbimet e Eko natyrës si dhe disa shërbime tjera kontraktuale qe kryhen në kuadër të Komunës, sqarimet tjera munden ti japin edhe drejtoret tjerë, faleminderit.
Afrim Kabashi – Drejtor gjithë kërkesat e qytetareve i kam ngritur përmes pyetjeve në Kuvend, mire kishe qene me organizu punëtori.
Nezir Bejta – Përshëndetje për të gjithë, shifrat në buxhet kur të shikohen si numra janë të mirë, mirëpo shpërndarja nuk është bërë si duhet secila drejtori është dashtë me qene me këmbëngulëse ne mënyrë qe me i mbulu kërkesat e drejtorive, te drejtoria e arsimit jan ndarë mjete mjafte pakë për shkake qe nuk mundet me i mbuluar kërkesat që janë, dy shkolla në qytete nuk kane projektor tash si mund të jetë gjendja ne shkollat tjera, Gjimnazi Hamëz Jashari dhe Rifat Mziu janë pa projektor, për laboratorë janë 8000€ janë mjafte pak, pastaj tabela interaktive janë paraparë 20,000€ çka me bërë me to kur një tabele kushton 5000€, keni investuar ne subqendra ma mire kishte me qene me ndërtuar ndonjë çerdhe, përfaqësime brenda vendi janë ndare 40,000€ kurse për tabela digjitale janë ndarë 30,000€, pastaj ka shpenzime shume ne dreka dhe darka, pastaj lagjia Osaj dhe Hamzaj ende janë pa ujë të pijshëm.

Behxhet Maliqi, DBF – Faleminderit Prof. realisht shqetësimet i kemi të njëjta e di se buxheti për arsim është i vogël mirëpo këto janë mundësit financiare, rritja e pagave ka ndikuar ne zvogëlimin e buxhetit për investime tjera, arsimi ka nevoje për përkrahje me te madhe ne mënyrë që të rritet edhe cilësia në arsim, faleminderit.

Kastriot Duraku – Faleminderit Kryesuese, përshëndetje për të gjithë, realisht një pjesë të madhe të çështjeve i sqaroj drejtori i financave, rreth çerdheve prof 4 vite rresht kemi bërë kërkesa vazhdimisht në Ministri të Arsimit, ku na janë përgjigjur vetëm për Polac e Runik, prapë kemi bërë kërkesa te reja presim se a po na u përgjigjen, për projektor jemi ne proces të lidhjes se një kontrate te re qe do ti furnizojmë, e di si nuk mjafton këta buxhet për arsim, mirëpo këto janë mundësit.

Nezir Bejta – Drejtor pajtohem me disa çka i the rreth kontratës kolektive nuk e keni kundërshtuar tash duhet me i bartë për sipër, pse dreka dhe darka kaq shumë të madhe, për tabela pak besoj.

Rrezarta Hasani Ibrahmi – Faleminderit Kryesuese, përshëndetje për të gjithë, kërkesa ime e parë është qe drejtoret duhet me qene në seancë këtu, kamë një pyetje për drejtorin e urbanizmit rregullimi i kulmeve të banesat e kuqe, cilat banesa i përfshin.

Nënkryetari, z. Fadil Nura – Faleminderit Kryesuese, sa i përket kontratës kolektive është kundërshtuar vazhdimisht, po thuajse të gjitha Komunat e kanë paditur Qeverinë e Kosovës, për pyetjen për banesat e kuqe përfshihen banesat e kuqe këtu afër Komunës.

Nezir Bejta – Pse nuk e keni kundërshtuar në fillim mirëpo krejt ne fund kur kane filluar përmbaruesit me i marr mjetet.

Nënkryetari, z. Fadil Nura – Ka qenë si proces në Gjykatë ndërsa Gjykata ja u ka njohur të drejtën, jemi shtyer deri në Supreme, ky vendim ka filluar të zbatohet ne vitin 2021-2022.

Kryesuesja e Kuvendit, Adelina Spahiu – Alija : Faleminderit, ju njoftoje se na u bashkëngjite në seancë edhe Burim Veliu, pasi që nuk ka tjerë për diskutim, shkojmë në votim, konstatojmë se me 19 për, 2 kundër dhe 0 abstenim, miratohet Propozim – Vendim për miratimin e buxhetit të Komunës së Skenderajt për vitin 2027 dhe parashikimi i buxhetit për vitin 2028-2029,vazhdojmë me piken e radhës Propozim – Vendim mbi lejimin e shfrytëzimit të mjeteve financiare në shumë prej 10,000€ (dhjetë mijë euro), për mbështetje financiare për Osman Bytyqi nga Fshati Abri e Poshtme, për rindërtim të shtëpisë së djegur si pasojë e zjarrit, **(raporton Kryetari i Komunës, z. Sami Lushtaku),**

Nënkryetari, z. Fadil Nura – Faleminderit Kryesuese, pasi qe materialin e keni marr me kohë, nuk po e zgjati shumë, bëhet fjalë për një rast qe ka ndodhur vitin e kaluar në Fshatin Abri e Poshtme qe është djegur shtëpia bashke me objekte përcjellëse dhe vetura qe ka kaluar ne djegie po thuajse 100% e qe për shkake të pengesave me buxhet vitin e kaluar nuk kemi mundur ti dalim ne ndihmë, andaj kërkoj nga ju qe ta miratoni këtë propozim – vendim.

Kryesuesja e Kuvendit, Adelina Spahiu – Alija : Faleminderit Nënkryetar, e hapi diskutimin.

Floriana Halili – Faleminderit Kryesuese, përshëndetje për të gjithë, ne jemi pro këtij propozim – vendimi, mirëpo shuma është e vogël ne krahasim me dëmet qe u janë shkaktuar.

Nënkryetari, z. Fadil Nura – Pajtohem Floriana, mirëpo këto janë mundësit financiare.

Kryesuesja e Kuvendit, Adelina Spahiu – Alija : Faleminderit, pasi qe tjerë për diskutim nuk ka shkojmë me votim, konstatojmë se me 20 vota për, 0 kundër dhe abstenim miratohet Propozim – Vendim për miratimin e buxhetit të Komunës së Skenderajt për vitin 2027 dhe parashikimi i buxhetit për vitin 2028-2029,vazhdojmë me piken e radhës Propozim – Vendim mbi lejimin e shfrytëzimit të mjeteve financiare në shumë prej 10,000€ (dhjetë mijë euro), për mbështetje

financiare për Osman Bytyqi nga Fshati Abri e Poshtme, për rindërtim të shtëpisë së djegur si pasojë e zjarrit, vazhdojmë me piken e radhës Propozim për miratimin e vendimit për mbështetjen financiare për NPL Eko- Natyra SH.A. Skenderaj me shumën prej 50,000.00€.

Nënkryetari, z. Fadil Nura – Faleminderit Kryesuese, nuk po e zgjati pasi qe materialin e keni para jush, propozimi vije pas kërkesës së Krye shefit të Eko- Natyres, për mbështetje financiare pasi problemet financiare qe kanë rrjedh e për ti mbuluar shpenzimet në paga për punëtor, është propozuar shuma për mbështetje në shumë prej 50,000.00€, andaj kërkoj qe ta miratoni.

Kryesuesja e Kuvendit, Adelina Spahiu – Alija : E hapi diskutimin.

Afrim Kabashi – Faleminderit Kryesuese, edhe në kpf kame jep sqarimet e mija, i përkrahi propozimet e tilla, sepse kjo ndërmarrje po bene punë të shkëlqyer , mirëpo duhet të mendohet qe ti krijojmë stabilitet financiar kësaj ndërmarrje, faleminderit.

Nezir Bejta – E përkrahi këtë propozim vendim, kjo ndërmarrje po bene pune te mira ne qytet, mirëpo është cekur edhe ne kërkese të ndërmarrjes mos inkasimi i mirë ka sjell ne këtë gjendje, domethënë nuk kane tregu rezultat te mire drejtorit.

Nënkryetari, z. Fadil Nura – Faleminderit për pyetjet, jemi munduar qe vazhdimisht me forcuar e përkrahur këtë ndërmarrje mirëpo i dimë problemet financiare e qe na kanë rrjedh.

Behxhet Maliqi, DBF – Prof nuk qëndron mos performanca mire e drejtorive.

Floriana Halili – Ju po thuni se përmbaruesi po na i merr parat pa na pyetur fare, kam dëgjuarës ju pyete e pse paraprakisht nuk u sugjeroni ju se ku me i marr.

Behxhet Maliqi, DBF – Pjesa me a e madhe nuk na kanë pyetur fare por edhe organizatat tjera nuk i kane pyetur.

Nezir Bejta – Këtë fjalën Qilerë pse spo e përdor ndonjë fjalë të gjuhës shqipe.

Behxhet Maliqi, DBF – Prof njësia kërkuese kështu e ka kërkuar.

Kryesuesja e Kuvendit, Adelina Spahiu – Alija : Pasi që tjerë për diskutim nuk ka shkojmë me votim, konstatojmë se me 19 për, 2 kundër dhe 1 abstenim miratohet Propozim për miratimin e vendimit për mbështetjen financiare për NPL Eko- Natyra SH.A. Skenderaj me shumën prej 50,000.00€, vazhdojmë me piken e radhës Propozim për miratimin paraprak të vendimit për dhënien ne shfrytëzim të pronave të paluajtshme të Komunës së Skenderaj, në shfrytëzim afatgjatë deri në 99 vite personit fizik/ juridik, parcelat me numër 699-10, 565-2, 569-0, dhe 570-1 prona publike në pronësi të Komunës, zona Kadastrale Skenderaj**(raporton z. Granit Musliu, drejtor DGJKP),**

Granit Musliu, DGJKP – Faleminderit Kryesuese, përshëndetje për të gjithë të pranishmit, po e prezantoj këtë propozim vendim në mungesë të Kryetarit të Komunës, pasi qe materialin e keni marr me kohë po e prezantoj në pika të shkurtër, propozimi - vendimi ka të beje me miratimin e vendimit për dhënien e pronave në shfrytëzim afat gjatë deri 99 vite, të bashkangjitur keni certifikatat e pronave, kopjet e planit, manualin gjeodezik, konfirmimet të planifikim hapësinor , këto prona i plotësojnë te gjitha kriteret për dhënie ne shfrytëzim duke u bazuar ne ligjin për dhënien ne shfrytëzim dhe këmbim si dhe rregulloren për përcaktimin e kritereve për dhënien ne shfrytëzim dhe këmbim te pronës komunale, qëllimi i dhënies ne shfrytëzim është përfitimi ekonomik i Komunës, andaj ju kërkoj qe ta miratoni këtë propozim – vendim.

Kryesuesja e Kuvendit, Adelina Spahiu – Alija : Faleminderit drejtor e hapi diskutimin.

Nezir Bejta – Po filloj si shaka po me bije si shpesh me juve mos me u pajtuar me juve po nuk e di si te pajtohem, te jepet prona komunale për 100 vite jeni shume dorshlirë me pronë publike, është akt i pa menduar mirë për 100 vite me u jep prona, pas 20 vite a 30 Qyteti zhvillohet dhe për brezat e rinjë nuk kemi pronë publike te ju lejmë nuk do të këtë vend ku të ndërtohet ndonjë çerdhe, kopshte, parking, shtëpi të pleqve apo diçka të ngjashme, se besoj se a ja vlen për 21% te

përfitimit të Komunës, kur e dimë vlerën e pronës në atë pjesë, njëjtë po veprohet si para tri vite qe u jep tregu i gjelbert për ndërtim e u zhvendos ne Polac tregu i gjelbert, kjo nuk është ne rregull i ftojë të gjithë asamblesitat qe mos ta votojnë këtë propozim – vendim sepse është i dëmshëm për Komunën tonë, faleminderit.

Floriana Halili – Faleminderit Kryesuese, siç e ceku edhe profa, është për keqardhje ky propozim, pasi që Skenderajt po thuajse po i merren pronat publike te fundit, brezat qe do vijnë do ju mbajnë përgjegjës për shkatërrimin qe po ja bëni këtij qyteti, ju e dini se pronat publike nuk munden te jepen ne shfrytëzim për ndërtim banesash, ne si lëvizje vetëvendosje do e përcjellim ne institucione gjyqësore këtë lënd me shpresë se ato institucione një dite do te lirohen e do ta trajtojnë këtë lënd.

Granit Musliu, DGJKP – Prapë po e përsëriti dokumentet e planifikimit pzhk dhe harta zonale nuk kanë paraparë në atë zonë as shkollë as çerdhe, sa i përket tregut të gjelbertë i ka pas skadu kontrata tregut, Floriana me gjeje diku ne ligj pasi qe është e destinuar me dokumente te planifikimit se nuk behet te ipet për ndërtim.

Afrim Kabashi – E di se kjo pikë kalon, mirëpo unë kam pasur dëshirë qe ajo pjese te jete për park, drejtor çka përfiton Komuna me këtë proces.

Granit Musliu, DGJKP – Faleminderit Afrim, sa i përket parqeve dhe objekteve tjera, dokumentet e planifikimit i parashohin, sa i përket përfitimit ekonomik të Komunës në këtë proces Komuna përfiton 21 % duke u bazuar ne rregulloren dhe aktet tjera.

Nezir Bejta – Po folni për dokumenta te planifikimit, a u kanë e planifikune muzeu ne parke si dhe QMF në oborrin e shkollës.

Arbnor Citaku , DUMA – Sa i përket muzeut, disa zona harta zonale përcakton mundësin me pas objekte të ngjashme të gjitha zonat janë të përcaktuara të definuara.

Armir Sejdiu – Përshëndetje për të gjithë, për Granitin desha të pyes pasi që po destinohet për banesa, blerësit e banesave a do munden me i qit ne emër te vetë banesat, apo a munden ti shesin këto banesa, ti fusin ne hipoteke, si dhe mbas disa viteve mund te vije dikush te ja u shkupës atë kontratë, kërkoj të na jepni sqarime.

Granit Musliu, DGJKP – Ne po flasim për dhënien ne shfrytëzim të pronave, çështja e shitjes se banesave bartja rregulloret me ligje tjera, munden mu shit mu ble kush të dojë, nuk do këtë asnjë pengës ligjore, prona kalon ne pronë private.

Kryesuesja e Kuvendit, Adelina Spahiu – Alija : Pasi qe nuk kemi tjerë për diskutim shkojmë me votim, konstatojmë se me 17 për, 3 kundër dhe 0 abstenim miratohet Propozim për miratimin paraprak të vendimit për dhënien ne shfrytëzim të pronave të paluajtshme të Komunës së Skenderaj, në shfrytëzim afatgjatë deri në 99 vite personit fizik/ juridik, parcelat me numër 699-10, 565-2, 569-0, dhe 570-1 prona publike në pronësi të Komunës, zona Kadastrale Skenderaj, vazhdojmë me piken e radhës Propozim për miratimin e vendimit për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të Komunës, përmes procedurës së shprehjes se interesit; parcelat Kadastrale me numër 699-10, 565-2, 569-0, dhe 570-1 prona publike në pronësi të Komunës zona Kadastrale Skenderaj, (**raporton z. Granit Musliu, drejtor DGJKP),**

Granit Musliu, DGJKP - Faleminderit Kryesuese, kjo pikë ndërlidhet me piken paraprake, qe kërkon formimin e komisionit ne procesin e dhënies ne shfrytëzim te pronave numër 699-10, 565-2, 569-0, dhe 570-1 prona publike në pronësi të Komunës, zona Kadastrale Skenderaj, komisioni përbehet prej 5 anëtareve, 2 ekzekutivi, 2 kuvendi dhe 1 shoqëria civile, andaj ju kërkoj qe Ta miratoni këtë propozim – vendim, faleminderit.

Kryesuesja e Kuvendit, Adelina Spahiu – Alija : Faleminderit drejtor, vazhdojmë me propozimet nga Kuvendi.

Alban Berisha – Faleminderit Kryesuese, nga subjekti politik PDK, propozoi Arlinda Haliti.
Nezir Bejta – Propozoj Floriana Halili.
Alban Berisha – Nga opozita propozoj Afrim Kabashi.
Afrim Kabashi – Nëse është e domosdoshme nga opozita, atëherë opozita u propozu a duhet dy nga opozita apo si.
Kryesuesja e Kuvendit, Adelina Spahiu – Alija : Kuvendi ka të drejt te propozoj e nëse janë me shume se dy propozime i qesim ne votim një nga një, pasi qe i kemi tri propozime nga Kuvendi votojmë veç e veç, kush është për Arlinda Haliti te jete pjese e këtij komisioni, 21 për, 0 kundër dhe 0 abstenim, votojmë për floriana Halili, 2 për 1 kundër dhe 0 abstenim, votojmë për Afrim kabashi 20 për, 0 kundër dhe 0 abstenim, kështu qe Arlinda Haliti dhe Afrim Kabashi marrin vota te mjaftueshme për te qene pjese e këtij Komisioni, tani fjalën ja kaloj drejtorit te kadastrit ti propozoj nga ekzekutivi.
Granit Musliu, DGJKP – Faleminderit Kryesuese, në mungesë të Kryetarit po i propozoj nga Ekzekutivi për Komisionin vlerësuese për dhënien në shfrytëzim të pronave te cekura ne propozim, Behxhet Maliqi drejtor i financave dhe mua Granit Musliu nga drejtoria për gjeodezi, kadastër dhe pronë.
Behxhet Maliqi, DBF – Faleminderit Kryesuese, materialin e kam lexuar me seriozitet të madh, me qe nje pjese e madhe e parcelave dalin edhe ne rrugë, unë personalisht nuk pranoj te jem pjesë e këtij Komisioni, faleminderit.
Granit Musliu, DGJKP – Me qe drejtori për financa u tërhiq, propozoi Kastriot Duraku drejtorin e Arsimit, për këtë komision, dhe Milazim Mustafen nga shoqëria civile.
Kryesuesja e Kuvendit, Adelina Spahiu – Alija : Pasi qe i murem propozime, shkojmë votim si pako te propozimit, me këtë përbërje Afrim Kabashi, Arlinda Haliti, Kastriot Duraku, Granit Musliu, Milazim Mustafa, votojmë, konstatojmë se me 18 për, 2 kundër dhe 0 abstenim miratohet Propozim për miratimin e vendimit për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të Komunës, përmes procedurës së shprehjes se interesit; parcelat Kadastrale me numër 699-10, 565-2, 569-0, dhe 570-1 prona publike në pronësi të Komunës zona Kadastrale Skenderaj, vazhdojmë me piken e radhës Propozim për miratimin e vendimit për formimin e Komisionit të ankesave për shqyrtimin e ankesave të palëve në procedurën e dhënies në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjate të pronës së paluajtshme të Komunës së Skenderajt, **(raporton z. Granit Musliu, drejtor DGJKP),**
Granit Musliu, DGJKP – Faleminderit Kryesuese, në mungesë të Kryetarit po e prezantoj edhe këtë pikë, edhe ky propozim vije pas dy propozimeve para këtij, qe ndërlidhet me dhënien e pronave ne shfrytëzim qe kërkon formimin e komisionit te ankesave komision i përbërë prej 5 anëtareve 2 nga ekzekutivi 2 nga kuvendi dhe 1 shoqëria civile, mandati i këtij komisioni është 2 vjeçar, andaj kërkoj qe ta miratoni.
Kryesuesja e Kuvendit, Adelina Spahiu – Alija : Faleminderit drejtor, kërkoj njëherë nga Kuvendit ti jepni propozimet për këtë komision.
Kushtrim Dragaj – Propozojmë Abdullah Gashi dhe Alban Berisha për këtë komision.
Floriana Halili – Nga Vetëvendosja propozoi Nezir Bejta.
Kryesuesja e Kuvendit, Adelina Spahiu – Alija : Pasi qe i kemi me shume se dy propozime, na u duhet qe te votojmë veq e veq, votojmë për Alban Berisha kush është për, kush kundër, abstenim, votojmë për Abdullah Gashi, kush është për, kundër abstenim, votojmë për Nezir Bejta kush është për, kundër abstenim, Po Nezir urdhëro.
Nezir Bejta – Tërhiqem , pasi qe pe shohim mënyrën se si po vendosni.

Kryesuesja e Kuvendit, Adelina Spahiu – Alija : Pasi qe Nezir Bejta u tërhiq, nga Kuvendi mbesin Abdullah Gashi dhe Alban Berisha, kërkoj nga ekzekutivi propozimet nga Ekzekutivi.
Granit Musliu, DGJKP – Në mungesë të Kryetarit nga Ekzekutivi propozoj për këtë komision te ankesave Enver Cerkini, përfaqësues ligjor i Komunës dhe Besarta Meha Ademi si dhe nga shoqëria civile Gentiana Zeqiri.
Kryesuesja e Kuvendit, Adelina Spahiu – Alija : Atëherë shkojmë ne votim te komisionit te ankesave me këtë përbërje Alban Berisha, Abdullah Gashi, Enver Cerkini, Besarta Meha Ademi, Gentiana Zeqiri, shkojmë me votim, konstatojmë se me 18 vota për, 2 kundër dhe 0 abstenim miratohet Propozim për miratimin e vendimit për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të Komunës, përmes procedurës së shprehjes se interesit; parcelat Kadastrale me numër 699-10, 565-2, 569-0, dhe 570-1 prona publike në pronësi të Komunës zona Kadastrale Skenderaj, vazhdojmë me piken e radhës, Propozim – Vendim për miratimin e Draft – Planit Komunal për Ri-integrimin e qëndrueshëm të personave të Ri-atdhesuar dhe integrimi e të huajve në Komunën e Skenderajt 2026-2028,(**raporton Zyrtari për Komunitete dhe Kthim, z. Fatmir Balaj),**
Fatmir Balaj – Faleminderit Kryesuese, përshëndetje për të gjithë , ky plan është hartuar nga komisioni profesional i caktuar nga Kryetari i Komunës, i bazuar në legjislacionin në fuqi i cili përmban objektivat, institucionet përgjegjëse për zbatim, pastaj afatet kohore , veprimet koston financiare, prezanton me radhe planin duke filluar nga objektivi i pare, ashtu siç është ne material i bashkangjitur drafti, faleminderit.
Kryesuesja e Kuvendit, Adelina Spahiu – Alija : Faleminderit Fatmir, e hap diskutimin, pasi qe nuk ka për diskutim shkojmë me votim konstatojmë se me 19 vota për, 0 kundër dhe 0 abstenim miratohet Propozim – Vendim për miratimin e Draft – Planit Komunal për Ri-integrimin e qëndrueshëm të personave të Ri-atdhesuar dhe integrimi e të huajve në Komunën e Skenderajt 2026-2028, vazhdojmë me piken e radhës Propozim – Vendim për shfuqizimin e vendimit Nr. 01-020/01-0020578/26, të datës; 04.06.2026, bazuar ne rekomandimin e Mapl-së, për zëvendësimin e anëtares se komitetit për komunitete, te cilën e prezantoj unë, Propozim – Vendim për shfuqizimin e vendimit Nr. 01-020/01-0020578/26, të datës; 04.06.2026, bazuar ne rekomandimin e Mapl-së, për zëvendësimin e anëtares se komitetit për komunitete, për këtë propozim raportoj unë i cili lidhet me vendimin e zëvendësimit të anëtares se komitetit për komunitete, te cilin vendim MAPL e ka kthyer të jashtëligjshëm e qe na u duhet ta respektojmë raportin e vlerësimit të MAPL, andaj kërkoj qe ta miratoni, e hapi diskutimin, pasi qe nuk ka për diskutim shkojmë me votim, konstatojmë se me 19 vota për , 2 kundër dhe 0 abstenim miratohet Propozim – Vendim për shfuqizimin e vendimit Nr. 01-020/01-0020578/26, të datës; 04.06.2026, bazuar ne rekomandimin e Mapl-së, për zëvendësimin e anëtares se komitetit për komunitete, vazhdojmë me piken e radhës, Diskutim rreth raportit të përformancës së Komunave për vitin 2025, (raporton koordinatori i performancës komunale, z. Baki Beqiri),
Nënkryetari, z. Fadil Nura – Faleminderit Kryesuese, po e prezantoj raportin e performances për vitin 2025, ne mungesë të koordinatorit të performances Baki Beqiri, materialin e kemi marr me kohë, sipas raportit Komuna e Skenderajt është renditur e treta ne nivel vendi sipas fushave të performances, raporti është i publikuar ne ueb faqe zyrtare të Mapl i cili përfshin 16 fusha të performances te cilën i shihni te specifikuar në tabele nuk po e zgjati me shume, faleminderit.
Kryesuesja e Kuvendit, Adelina Spahiu – Alija : Faleminderit Nënkryetar e hapi diskutimin për këtë raport.
Afrim Kabashi – Faleminderit Kryesuese, me erdhe mire për disa indekator qe ishin me 100% mirëpo disa tjerë me përqindje me të vogël si pjesëmarrja e qytetareve në konsultime me përqindje

të vogël 19,35%, pastaj numri i akteve te publikuar ne raport pastaj te zgjedhja e këshillave te fshatrave si dhe te sipërfaqja me hapësira te gjelberta me përqindje te vogël, ka qene mire me i permisu këto pika këta indikator, Nenkryetar desha te pyes se pse Komuna e jone nuk po përfiton grandin e performances e qe po e shohim Drenasin qe 9 here radhazi po e fitojnë.
Nënkryetari, z. Fadil Nura – Faleminderit Afrim, sa për njohuri Komuna e jone ne vitin 2023 ka fituar grandin 1 milion e 200,000.00€, mirëpo ne vitin 2024 na ka sjellur telashe kontrata kolektive si po thuajse te gjitha Komunat, çështjen e disa indikatorve me përqindje te vogël janë me shume për shkake te disa probleme teknike se ne realitet qëndrojmë mire.
Kryesuesja e Kuvendit, Adelina Spahiu – Alija : Faleminderit pasi qe tjerë për diskutim nuk ka shkojmë me votim, konstatojmë se me 19 vota për 2 kundër dhe 0 abstenim përkrahet Diskutim rreth raportit të përformancës së Komunave për vitin 2025, vazhdojmë me piken e radhës Propozim – vendim për inicimin e procedurës për themelimin e QMF-së në Kuadër të QKMF-së, raporton z. Hasan Hoti DSHMS.
Hasan Hoti, DSHMS – Faleminderit Kryesuese, përshëndetje për të gjithë, propozimi ne fjalë është i bazuar në nenin 40 të ligjin për shëndetësi dhe rregullores nenit 6 të udhëzimit për shëndetësi jemi konsultuar me Ministri të Shëndetësisë the na kanë rekomanduar që për themelim të QMF duhet qe përmes Kuvendit të fillojmë procedurat e themelimit, gjithçka është konsultuar, nuk po e zgjati me shume faleminderit.
Kryesuesja e Kuvendit, Adelina Spahiu – Alija : Faleminderit drejtor e hapi diskutimin.
Nezir Bejta – Faleminderit Kryesuese, drejtor është dashur me herët te na vije te kem sqarime me shume me dit se cka po votojmë.
Nënkryetari, z. Fadil Nura – Prof është konsultuar gjithçka me Ministri te shëndetësisë është sqaruar para se te vije këtu ne Kuvend.
Rrezarta Hasani Ibrahimi – Faleminderit Kryesuese, mendoj se është dashur me shume te analizohet deri tek ky propozim, shihet ne procesverbale janë vendosur ligje qe nuk janë me në fuqi gjithashtu procesverbale te pa përfunduar, gjithashtu është dashur te ceken personat përgjegjës për këtë proces.
Nënkryetari, z. Fadil Nura – Rreze është konsultuar Ministria e shëndetësisë është analizuar para prakisht, ato procesverbale janë te QKMF, propozime është bazuar ne ligjet ne fuqi.
Hasan Hoti, DSHMS – Rreze Nënkryetari veç i tha te gjitha sqarimet, jemi konsultuar paraprakisht është analizuar.
Kryesuesja e Kuvendit, Adelina Spahiu – Alija : Pasi qe tjerë për diskutim nuk ka shkojmë me votim, konstatojmë se me 17 për, 2 kundër dhe 0 abstenim miratohet Propozim – vendim për inicimin e procedurës për themelimin e QMF-së në Kuadër të QKMF-së, vazhdojmë me piken e radhës, Pyetjet e këshilltare nën piken të ndryshme.
Nezir Bejta – Faleminderit Kryesuese, kame tri pyetje për drejtorin e arsimit, sipas raportit te institutit GAP ne Komunën tonc janë larguar rreth 160 mësimdhënës, nga gradi qeveritar, si është puna me ta, a mund ti përballoj Komuna pagat e tyre pyetja e dyte ka te beje me çerdhen Sala dhe Hamit Jashari, a keni vendos kondicioner si dhe pyetje për drejtorin e shërbimeve publike rreth kompanisë uniteti nuk po me kryer punën e vete neper fshatra.
Kastriot Duraku, DKA - Prof sipas atij raporti të GAP të gjitha Komunat kane dal deficit ne staf arsimor, raport i bazuar ne udhëzim te vjetër, dhe asnjë mësimdhënës nuk është jashtë listës se pagave, për çerdhe, ajo çerdhe është e pajisur me standardë është e pajisur me kondicioner , ajrosje nxemje qendrore i ka të gjitha.
Afrim Kabashi – Kryesuese dy pyetje kom mare përgjigjeje sa ka mundësi qe drejtoria e arsimit shkollës ne Makermal të ju siguroj ujë të pijshëm, si dhe pyetjen tjetër për drejtorin e bujqësisë a

i keni monitori dy fermerët qe i kemi nda mjete nga Kuvendi Misim Shabani nga Dasheci si dhe Armend Thaqi nga Buroja a i kan realizu projektet me mjetet qe ja u kemi ndarë.
Kastriot Duraku, DKA- Rreth furnizimit e ujë të pijshëm të Shkollës në Makerrmal, jemi ne proces se shpejti do të zgjidhjet ajë problem.
Sabit Ferizi, DBPZHR- Faleminderit Afrim për pyetjet, po të dy fermerët i kemi monitorua, Misim Shabani dhe Armend Thaqi, qe te dytë janë dukc i realizuar projektet me mjetet qe ja u kemi ndarë e qe të dytë janë fermerë mjafte të mirë.
Kryesuesja e Kuvendit, Adelina Spahiu – Alija : Pasi qe veç i trajtuam te gjitha pikat e rendit të ditës, e mbylli këtë takim, mire u pafshim ne seancën e radhës.

Procesmbajtësi

Kryesuesja e Kuvendit